SONY

4-456-714-12 (1) (AL)

Sistemi personal audio

AL Udhëzimet e përdorimit

* 4 4 5 6 7 1 4 1 2 * (1)

©2013 Sony Corporation

CMT-BT60/BT60B

http://www.sony.net/

PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj.
Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në rafte librash apo në mobilie me mur.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, lidheni njësinë në priza të rrymës alternative që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë spinën kryesore nga priza e rrymës alternative.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është e lidhur në prizën e rrymës alternative, edhe nëse vetë njësia është e fikur.

Kjo pllakëz metalike ndodhet në pjesën e jashtme të poshtme.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur në përputhje me kufijtë e përcaktuar në Direktivën EMC për përdorimin e një kabllolje lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

KUJDES

Përdorimi i mjeteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT

Kjo pajisje klasifikohet si produkt LAZER i KATEGORISË 1. Kjo shenjë ndodhet në pjesën e jashtme të poshtme të njësisë.

Për klientët në Australi

Kjo pajisje duhet të instalohet dhe të përdoret me të paktën 20 cm dhe më shumë largësi mes radiatorit dhe trupit të personit (duke përjashtuar gjymtyrët: duart dhe kyçet e tyre, këmbët dhe kyçet e tyre).

Për klientët në Evropë

Kabllot dhe bashkuesit e mbrojtur dhe të tokëzuar si duhet, duhet të përdoren për lidhjen e kompjuterëve pritës dhe/ose pajisjeve periferike.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm në pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.

Kë produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuni adresave që jepen në dokumentet e posaqme të shërbimit ose të garancisë.

Shënim për DualDisc-et

Një DualDisc është një produkt disk me dy anë i cili përmban material të regjistruar DVD në njërën anë dhe material dixhital audio në anën tjetër. Megjithatë, duke qenë se ana me material audio nuk është konform me standardin e kompakt-diskut (CD), nuk garantohet riprodhimi në këtë produkt.

Disqet muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit

Ky produkt është krijuar për të luajtur disqe që ndjekin standardin e kompakt diskut (CD). Kohët e fundit, disa kompani regjistrimesh tregtojnë disqe të ndryshme muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Ju lutemi vini re se mes këtyre disqeve ka të tilla që nuk janë konform me standardin CD, dhe mund të mos luhen dot nga ky produkt.

Njoftim për licencën dhe markat tregtare

- Windows Media është marka tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Shenja e fjalës dhe logot BLUETOOTH® janë marka tregtare të regjistruara që zotërohen nga BLUETOOTH SIG, Inc. dhe çdo përdorim i tyre nga Sony Corporation bëhet me licencë.
- Marka N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtetet të tjera.
- Android është markë tregtare e Google Inc.
- Ky produkt mbrohet nga teknologji të caktuara që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft ose një filial i autorizuar i Microsoft.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të treguara në këtë manual janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesit. Shenjat ™ dhe ® janë hequr në këtë manual.

Për klientët në Evropë dhe Australi

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (vlen për Bashkimin Evropian dhe shtetet të tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Vetëm për Evropën

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme grumbullimi të diferencuar)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që jepet me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.
Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.
Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.
Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi.
Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.
Për të dhëna më të hollësishme mbi riciklimin e këtij produkti ose të baterisë, kontaktoni me bashkinë, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Për detaje, vizitoni URL-në e mëposhtme:
http://www.compliance.sony.de/

Vendndodhja e kontrolleve

Njësia (larë)



Telekomanda



Ky manual shpjegon kryesisht veprimet me telekomandën, por të njëjtat veprime mund të kryhen duke përdorur butonat në njësi që kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm.

Fillimi



A Antenat

Ⓐ Antena përcjellëse DAB/FM (e përfshirë) (vetëm CMT-BT60B)
Ⓑ Antena përcjellëse FM (e përfshirë) (vetëm CMT-BT60)
Ⓒ Antena qarkore AM (e përfshirë) (vetëm CMT-BT60)

Gjeni një pikë dhe një orientim që ofron marrje të mirë sinjali dhë më pas vendosni antenat në një sipërfaqe të qëndrueshme (dritare, mur, etj.).
Mbajeni antenat larg nga njësia, kordoni elektrik dhe komponentët e tjerë për të shmangur kapjen e zhurmës.
Siguroni fundin e antenës përcjellëse FM me shirit ngjitës.

B Hyrja e energjisë (AC IN)

Pasi të lidhni të gjitha pajisjet, lidhni kordonin elektrik Ⓑ me prizën në mur.

C Porta USB

Lidhni një pajisje USB me portën USB duke përdorur një kabllo USB (nuk është e përfshirë).

D Foleja AUDIO IN (hyrje e jashtme)

Lidhni pajisjen e jashtme opsionale me një kabllo të lidhjes audio (nuk është e përfshirë).

Për të përgatitur antenën qarkore AM

Hapni kordonin e antenës të mbledhur rreth antenës dhe ngrini mbështetësen e antenës.

Vendoseni antenën dhe sigurojeni në vendin përkatës sa të dëgjohet një kërcitje.

Vendosja e orës

1 Shtypni I/⏻ 2 për të ndezur sistemin.
2 Shtypni TIMER MENU 18 për të zgjedhur modalitetin e cilësimit të orës.
Nëse pulson „PLAY SET", shtypni ♦/♦ 23 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur „CLOCK", dhe më pas shtypni ⊕ (hyrje) 32.
3 Shtypni ♦/♦ 23 në mënyrë të përsëritur për të vendosur orën, më pas shtypni ⊕ (hyrje) 32.
4 Përdorni të njëjtën procedurë për të cilësuar minutat.

Shënim
Cilësimet e orës rivendosen kur shkëputni kordonin e rrymës ose nëse ndodh shkëputje e energjisë elektrike.

Për të shfaqur orën kur sistemi është i fikur

Shtypni DISPLAY 27 në mënyrë të përsëritur për të shfaqur orën. Ora shfaqet për rreth 8 sekonda.
Nëse sistemi është në modalitetin e gatishmërisë së BLUETOOTH, ora nuk shfaqet kur shtypni DISPLAY 27.

Marrja e stacionit të radios DAB/DAB+ (vetëm CMT-BT60B)

Kur e ndizni sistemin për herë të parë pasi e keni bërë, skanimi automatik DAB fillon automatikisht dhe krijon një listë të shërbimeve të disponueshme. Gjatë skanimit automatik DAB shfaqet „********". Mos shtypni asnjë buton në njësi ose në telekomandë gjatë skanimit automatik DAB. Skanimi ndërpritet dhe lista e shërbimit mund të mos krijohet si duhet. Për të ekzekutuar skanimin automatik DAB në mënyrë manuale, kryeni procedurën e „Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale". Nëse keni lëvizur në një zonë tjetër, kryeni manualisht skanimin automatik DAB dhe regjistroni përsëri përmbajtjet e transmetimeve.

Funksionimet

Luajtja e një disku CD-DA/MP3

1 Shtypni CD FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në njësi në mënyrë të përsëritur deri sa „CD" të shfaqet në ekran 13.
2 Futni një disk në folenë e diskut me anën e etiketës të drejtuar përpara.



⏏ 7 Nxirrni diskun.

Riprodhimi fillon automatikisht pasi zhduket „READING".
Nëse e ndryshoni nga një funksion tjetër në funksionin e CD-së kur një disk është i futur tashmë në folenë e diskut, shtypni ▶II 4 për të nisur riprodhimin.

Shënime
- Diskët 8 cm nuk mund të përdoren në këtë sistem.
- Mos futni një disk 8 cm me një përshtatës. Duke vepruar kështu mund të shkaktoni keqfunksionim të sistemit.
- Nuk mund të futni një disk në folenë e diskut kur në ekran nuk shfaqet „NO DISC".
- Nëse nuk mund të futni një disk në folenë e diskut edhe kur në ekran shfaqet „NO DISC", mund të ketë aktualisht një disk në fole. Mbani të shtypur të ⏏ 7 për të nxjerrë një disk të tillë me forcë. Nëse as sistemi nuk e nxjerr diskun, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.
- Nëse nuk mund ta nxirrni diskun dhe në ekran shfaqet „LOCKED", kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.
- Mos futni disqe me forma jostandarde (p.sh. në formë zemre, katrore, ylli). Diski mund të bjerë brenda në sistem dhe mund të shkaktojë dëme të paripareushme.
- Mos e fikni sistemin kur disku është gjysmë i futur në folenë e diskut. Duke vepruar kështu mund të bëni që disku të bjerë.
- Mos përdorni disqe me shirita, izolues apo njësi gjatësore mbi to, pasi kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.
- Kur hiqni një disk, kapeni diskun nga cepat. Mos e prekni sipërfaqen.

Funksionimet e tjera

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ▶II 4. Për të rifilluar luajtjen, shtypni sërish butonin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ 5.
Zgjedhjen e një pjese ose skedari	Shtypni ⏮/⏭ 6.
Gjetjen e një pike në një pjesë ose skedar	Mbani shtypur ⏪/⏩ 6 (ose ⏮/⏭ 6 në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.
Zgjedhjen e luajtjes me përsëritje	Shtypni REPEAT 25 në mënyrë të përsëritur deri sa të shfaqen „🔁" (të gjitha pjesët ose skedarët) ose „🔁 1" (pjesa ose skedari tek).
Zgjedhjen e një dosjeje në një disk MP3	Shtypni 🗀 +/− 23 në mënyrë të përsëritur.
Nxjerrjen e një disku	Shtypni ⏏ 7 në njësi.

Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Shtypni PLAY MODE 26 në mënyrë të përsëritur ndërkohë që luajtësi është i ndaluar. Ju mund të zgjidhni modalitetin e luajtjes normale (nuk shfaqet ndonjë tregues ose shfaqet „FLDR"*), modalitetin e luajtjes me përzierje (shfaqet „SHUF" ose „FLDR SHUF"*) ose modalitetin e luajtjes së programit (shfaqet „PGM").

Modaliteti i luajtjes



* Kur shfaqet „FLDR" ose „FLDR SHUF", do të luhen të gjithë skedarët në dosjen e zgjedhur në diskun MP3. Kur luani një disk CD-DA, sistemi kryen të njëjtin funksion si luajtja normale (nuk ka treguesi ose luajtja me përzierje „SHUF".

Kur shfaqet „PUSH STOP"
Ju nuk mund ta ndryshoni modalitetin e luajtjes gjatë riprodhimit. Ndaloni riprodhimin dhe më pas ndryshoni modalitetin e luajtjes.

Shënime mbi modalitetin e luajtjes
Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, modaliteti i luajtjes kthehet te luajtja normale.

Shënime mbi luajtjen e përsëritur
- „🔁" tregon se të gjitha pjesët ose skedarët do të përsëriten derisa të ndaloni riprodhimin.
- „🔁 1" tregon se një pjesë ose një skedar do të përsëritet derisa të ndaloni riprodhimin.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, luajtja e përsëritur do të anulohet.

Shënime mbi modalitetin e luajtjes së përzier
- Kur modaliteti i luajtjes së përzier vendoset në „SHUF", sistemi luan me përzierje të gjitha pjesët ose skedarët në disk. Kur modaliteti i luajtjes së përzier vendoset në „FLDR SHUF", sistemi luan me përzierje të gjitha pjesët ose skedarët në dosjen e zgjedhur.
- Kur fikni sistemin, modaliteti i përzgjedhur i luajtjes me përzierje („SHUF" ose „FLDR SHUF") pastrohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në modalitetin e luajtjes normale ose FLDR.

Shënime për luajtjen e disqeve MP3
- Mos ruani dosje ose skedarë të panevojshëm në një disk që ka skedarë MP3.
- Dosjet që nuk kanë skedarë MP3 nuk njihen në sistem.
- Sistemi mund të luajë vetëm skedarët MP3 që kanë një prapashtesë skedari „.mp3".
- Edhe kur emri i skedarit ka prapashtesën „.mp3", nëse nuk është një skedar audio MP3, luajtja e këtij skedari mund të gjenerojë një zhurmë të lartë që mund të shkaktojë dëmtim të sistemit.
- Numri maksimal i dosjeve dhe skedarëve MP3 të përputhshëm me këtë sistem është:
  —999* dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë)
  —999 skedarë
  —250 skedarë në një dosje të vetme
  —8 nivele dosjesh (në strukturë peme skedarësh)
- Nuk mund të garantohet pajtueshëmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues të MP3, njësinë e CD-R/RW dhe pajisjen regjistruese, si dhe materialet e regjistrimit. Disqet MP3 që nuk janë të pajtueshëm mund të prodhojnë zhurmë ose audio të ndërprerunë ose mund të mos luhen fare.

* Kjo përfshin dosjet që nuk kanë MP3 ose skedarë të tjerë. Numri i dosjeve që sistemi mund të njohë mund të jetë më i vogël se numri aktual i dosjeve, në varësi të strukturës së dosjeve.

Krijimi i programit personal (Luajtja e programit)

1 Shtypni CD FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në njësi në mënyrë të përsëritur deri sa „CD" të shfaqet në ekran 13.
2 Shtypni PLAY MODE 26 në mënyrë të përsëritur derisa „PGM" të shfaqet gjatë kohës që luajtësi është ndaluar.
3 Zgjidhni një dosje (vetëm disk MP3).
Shtypni 🗀 +/ − 23 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur dosjen e dëshiruar.
Nëse dëshironi që të programoni të gjithë skedarët në dosje, shtypni ⊕ 32.
4 Zgjidhni numrin e pjesës ose skedarit të dëshiruar.
Shtypni ⏮/⏭ 6 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet numri i pjesës ose i skedarit të dëshiruar.



Numri i pjesës ose skedarit të zgjedhur — **Koha totale e luajtjes së pjesës ose skedarit të zgjedhur**

5 Shtypni ⊕ 32.
„--:--" shfaqet kur koha totale e luajtjes kalon 100 minuta për një CD-DA ose kur programoni skedarë MP3.
6 Përsëritni hapat 3 deri në 5 për të programuar pjesë ose skedarë shtesë, deri në 25 pjesë ose skedarë.
7 Shtypni ▶II 4.
Programi juaj për pjesët ose skedarët do të fillojë riprodhimin.
Programi mbetet i disponueshëm deri sa të hiqni diskun nga foleja e diskut 15 ose të shkëputni kordonin elektrik.
Për të luajtur përsëri të njëjtin program, shtypni ▶II 4.

Për të anuluar luajtjen e programit

Shtypni PLAY MODE 26 në mënyrë të përsëritur derisa „PGM" të zhduket gjatë kohës që luajtësi është ndaluar.

Për të fshirë pjesën ose skedarin e fundit të programit

Shtypni CLEAR 30 në mënyrë të përsëritur ndërkohë që luajtësi është i ndaluar.

Shënime
- Nëse disku nxirret pas programimit, të gjitha pjesët ose skedarët e programuar do të fshihen.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, pjesët ose skedarët e programuar do të fshihen.

Dëgjimi i radios

Sintonizimi të një stacion radioje

1 Shtypni TUNER FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në mënyrë të përsëritur deri sa „FM" ose „AM" (CMT-BT60), ose „DAB" ose „FM" (CMT-BT60B).
2 Kryeni sintonizimin.

Për skanimin automatik
Shtypni TUNING MODE 20 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet „AUTO", dhe më pas shtypni TUNE +/− 6. Skanimi ndalon automatikisht kur sintonizohet në një stacion dhe „ST" (vetëm për programet stereo) shfaqet në ekran 13.

Nëse skanimi nuk ndalon, shtypni ■ 5 për të ndaluar skanimin, më pas kryeni sintonizimin manual (më poshtë).
Kur sintonizoheni në një stacion që ofron shërbime RDS, transmetuesit japin informacione të tilla si emrin e shërbimit ose emrin e stacionit.

Për sintonizimin manual
Shtypni TUNING MODE 20 mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet „MANUAL", më pas shtypni TUNE +/− 6 në mënyrë të përsëritur për t'u sintonizuar në stacionin e dëshiruar.

Shënime mbi stacionet DAB/DAB+
- Para se të sintonizoheni në stacionet DAB/DAB+, sigurohuni që të jetë kryer skanimi fillestar i DAB.
- Kur sintonizoheni në një stacion që ofron shërbime RDS, transmetuesit japin informacione të tilla si emrin e shërbimit ose emrin e stacionit.
- Kur sintonizoheni në një stacion DAB/DAB+, mund të duhen disa sekonda para se të dëgjoni një zë.
- Shërbimi parësor merret automatikisht kur mbyllet shërbimi dytësor.
- Ky sintonizues nuk mbështet shërbimet e të dhënave.

Këshillë
Për të reduktuar zhurmën statike në një stacion të dobët FM stereo, shtypni FM MODE 21 në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet „MONO" për të çaktivizuar marrjen stereo.

Për të ndryshuar intervalin e sintonizimit AM (përveç se për modelet e Evropës dhe të Rusisë)

Cilësimi i paracaktuar për intervalin e sintonizimit AM është 9 kHz (ose 10 kHz për disa zona).
Përdorni butonat në njësi për të kryer këtë veprim.

1 Shtypni TUNER FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në njësi në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur stacionin AM.
2 Shtypni I/⏻ 2 për të fikur sistemin.
3 Mbani të shtypur FUNCTION 3 dhe shtypni I/⏻ 2 në njësi.
„STEP 9K" ose „STEP 10K" shfaqet në ekran. Kur ndryshoni intervalin, të gjitha stacionet e paravendosura AM do të fshihen.

Ekzekutimi i skanimit automatik DAB në mënyrë manuale (vetëm CMT-BT60B)

Para se të mund të sintonizoheni në stacionet DAB/DAB+, duhet të kryeni një skanim fillestar të DAB.
Kur të keni lëvizur në një zonë tjetër, kryeni po ashtu skanimin fillestar të DAB për të përditësuar manualisht informacionin e shërbimit DAB/DAB+.

1 Shtypni TUNER FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në njësi në mënyrë të përsëritur në njësi deri sa të shfaqet „DAB" në ekran 13.
2 Shtypni OPTIONS 33 për të shfaqur menynë e cilësimeve.
3 Shtypni ♦/♦ 23 me mënyrë të përsëritur për të zgjedhur „INITIAL" dhe më pas shtypni ⊕ 32.
4 Shtypni ♦/♦ 23 me mënyrë të përsëritur për të zgjedhur „OK" dhe më pas shtypni ⊕ 32.
Skanimi do të fillojë. Progresi i skanimit tregohet nga yjet (******). Në varësi të shërbimeve DAB/DAB+ të disponueshme në zonën tuaj, skanimi mund të zgjasë disa minuta.
Kur përfundon skanimi, krijohet një listë e shërbimeve të disponueshme.

Shënime
- Nëse vendi ose rajoni juaj nuk e mbështet transmetimin DAB/DAB+, shfaqet „NO SERV".
- Kjo procedurë gjatë të gjitha paravendosjet e ruajtura më parë.
- Para se të shkëputni antenën DAB/FM, sigurohuni që sistemi të jetë i fikur për të ruajtur cilësimet tuaja të DAB/DAB+.

Paravendosja e stacioneve të radios

1 Sintonizohuni në stacionin e dëshiruar.
2 Shtypni TUNER MEMORY 22.

Numri i paravendosjes



3 Shtypni TUNE +/− 6 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur një numër të paravendosur.
Nëse është caktuar një stacion tjetër në numrin e paravendosur të zgjedhur, stacioni zëvendësohet me stacionin e ri.
4 Shtypni ⊕ 32 për të regjistruar stacionin.
"COMPLETE" shfaqet në ekran 13.
5 Përsëritni hapat 1 deri 4 për të regjistruar stacionet e tjera.
Ju mund të paravendosni deri në 20 stacione FM, 10 stacione AM (vetëm CMT-BT60) dhe 20 stacione DAB/DAB+ (vetëm CMT-BT60B).

Për t'u sintonizuar te një stacion radioje i paravendosur

Shtypni TUNING MODE 20 në mënyrë të përsëritur deri sa „PRESET" të shfaqet në ekran 13 dhe më pas shtypni TUNE +/− 6 për të zgjedhur numrin e paravendosur të ruajtur i cili është regjistruar tacioni i dëshiruar.

Luajtja e një skedari në një pajisje USB

Ju mund të luani skedarët audio të ruajtur në një pajisje USB duke lidhur një memorie USB ose pajisje USB me sistemin. Formati audio që mund të luhet është MP3/WMA*/AAC*.
Kontrolloni faqet e mëposhtme të internetit për informacion mbi pajisjet e pajtueshme USB.
Për klientët në Evropë:
http://support.sony-europe.com/
Për klientët në Amerikën Latine:
http://www.sony-latin.com/index.crp
Për klientët në vende/rajone të tjera:
http://www.sony-asia.com/support

* Skedarët me mbrojtje të të drejtave të autorit DRM (Menaxhimi i të drejtave dixhitale) ose skedarët e shkarkuar nga një dyqan muzikor në linjë nuk mund të luhen në këtë sistem. Nëse provoni të luani një nga këta skedarë, sistemi luan skedarin të pambrojtur audio të radhës.

1 Shtypni USB FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në mënyrë të përsëritur në njësi deri sa të shfaqet „USB" në ekran 13.
2 Lidhni pajisjen USB drejtpërdrejt ose nëpërmjet kabllos USB të pajisjes USB me portën USB ◘ në njësi.
3 Shtypni ▶II 4 për të nisur riprodhimin.

Funksionimet e tjera

Për	Veproni si më poshtë:
Ndërprerjen e riprodhimit	Shtypni ▶II 4. Për të rifilluar luajtjen, shtypni sërish butonin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ 5. Për të rifilluar luajtjen, shtypni ▶II 4 [1]. Për të anuluar rifillimin e riprodhimit, shtypni ■ 5 sërish[2].
Zgjedhjen e një dosjeje	Shtypni 🗀 +/ − 23 në mënyrë të përsëritur.
Zgjedhjen e një skedari	Shtypni ⏮/⏭ 6.
Gjetjen e një pike në një skedar	Mbani shtypur ⏪/⏩ 6 (⏮/⏭ 6 në njësi) gjatë riprodhimit dhe lëshojeni butonin te pika e dëshiruar.
Zgjedhjen e luajtjes me përsëritje	Shtypni REPEAT 25 në mënyrë të përsëritur deri sa të shfaqen „🔁" (të gjithë skedarët audio) ose „🔁 1" (skedari audio i vetëm)

[1] Kur luani një skedar VBR MP3/WMA, sistemi mund të rifillojë riprodhimin nga një pikë tjetër.
[2] Rifillimi i luajtjes kthehet në numrin e dosjeve.

Për të ndryshuar modalitetin e luajtjes

Shtypni PLAY MODE 26 në mënyrë të përsëritur ndërkohë që luajtësi është i ndaluar. Ju mund të zgjidhni modalitetin e luajtjes normale (nuk shfaqet ndonjë tregues ose shfaqet „FLDR"[1]) ose modalitetin e luajtjes me përzierje (shfaqet „SHUF" ose „FLDR SHUF"[2]).

[1] Kur nuk zgjidhet asnjë tregues, sistemi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Kur zgjidhet „FLDR", sistemi lexon të gjithë skedarët në dosjen e zgjedhur në pajisjen USB.
[2] Kur zgjidhet „SHUF", sistemi lexon me përzierje të gjithë skedarët audio në pajisjen USB. Kur zgjidhet „FLDR SHUF", sistemi lexon me përzierje të gjithë skedarët audio në dosjen e zgjedhur.

Shënim mbi modalitetin e luajtjes
Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, modaliteti i luajtjes kthehet te luajtja normale.

Shënime mbi luajtjen e përsëritur
- „🔁" tregon se të gjithë skedarët do të përsëriten deri sa të ndaloni riprodhimin.
- „🔁 1" tregon se një skedar do të përsëritet derisa të ndaloni riprodhimin.
- Nëse kordoni elektrik shkëputet kur sistemi është i ndezur, luajtja e përsëritur do të anulohet.

Shënime mbi modalitetin e luajtjes së përzier
Kur fikni sistemin, modaliteti i përzgjedhur i luajtjes me përzierje („SHUF" ose „FLDR SHUF") pastrohet dhe modaliteti i luajtjes kthehet në modalitetin e luajtjes normale (nuk ka treguesi ose „FLDR").

Shënime
- Rendi i riprodhimit për sistemin mund të ndryshojë nga rendi i riprodhimit të luajtësit dixhital muzikor të lidhur.
- Sigurohuni të fikni sistemin përpara se të hiqni pajisjen USB. Heqja e pajisjes USB gjatë kohës që sistemi është i ndezur, mund të prishë të dhënat në pajisjen USB.
- Kur nevojitet lidhja me kabllo USB, lidhni kabllon USB që keni marrë me pajisjen USB që do të lidhet. Për detajet e lidhjes, referojuni manualit të përdorimit të pajisjes USB.
- Mund të duhet pak kohë përpara se të shfaqet „READING" pas lidhjes, në varësi të llojit të pajisjes USB të lidhur.
- Mos e lidhni pajisjen USB nëpërmjet një qendre USB.
- Kur lidhet pajisja USB, sistemi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Nëse ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB, mund të duhet shumë kohë që të përfundojë leximi i pajisjes USB.
- Për disa pajisje USB të lidhura mund të duhet më shumë kohë për të transmetuar sinjalet nga sistemi ose për të përfunduar leximin e pajisjes USB.
- Nuk mund të garantohet pajtueshëmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues. Nëse skedarët audio në pajisjen USB janë koduar fillimisht me softuerë të papajtueshëm, ata skedarë mund të prodhojnë zhurmë ose mund të mos funksionojnë.
- Numri maksimal i dosjeve dhe skedarëve në pajisjen USB të përputhshme me këtë sistem është:
  —1 000* dosje (duke përfshirë dosjen rrënjë)
  —3 000 skedarë
  —250 skedarë në një dosje të vetme
  —8 nivele dosjesh (në strukturë peme skedarësh)

* Kjo përfshin dosjet që nuk kanë skedarë audio që mund të luhen dhe që kanë dosje boshe. Numri i dosjeve që sistemi mund të njohë mund të jetë më i vogël se numri aktual i dosjeve, në varësi të strukturës së dosjeve.

- Sistemi nuk i mbështet domosdoshmërisht të gjitha funksionet e dhëna në pajisjen e lidhur USB.
- Dosjet që nuk kanë skedarë audio nuk njihen.
- Formatet audio që mund të dëgjoni me këtë sistem janë si më poshtë:
  —MP3: prapashtesa ".mp3"
  —WMA: prapashtesa ".wma"
  —AAC: prapashtesa e skedarit ".m4a", „mp4" ose ".3gp"

Vini re se edhe kur emri i skedarit ka një prapashtesë të saktë, nëse vetë skedari është i ndryshëm, sistemi mund të prodhojë zhurmë ose mund të keqfunksionojë.

Ngarkimi i një pajisjeje USB ose iPod/iPhone/iPad

Nëse lidhni një pajisje USB ose një iPod/iPhone/iPad në portën USB ◘ kur sistemi është i ndezur, ngarkimi do të filloj automatikisht.

Për të ndaluar ngarkimin e pajisjes USB

Shtypni I/⏻ 2 për të fikur sistemin dhe më pas shkëputni kabllon USB.

Shënim
Ju nuk mund të ngarkoni një pajisje USB ose iPod/iPhone/iPad kur sistemi është i fikur. Disa pajisje USB dhe iPod/iPhone mund të mos ngarkohen për shkak të karakteristikave të tyre.

Përdorimi i funksionit BLUETOOTH

Ju mund të dëgjoni muzikë nga „WALKMAN" ose pajisja juaj BLUETOOTH nëpërmjet një lidhje me valë.

Pajisja BLUETOOTH si „WALKMAN"

Ky sistem mbështet profilet A2DP dhe AVRCP BLUETOOTH. Për detaje mbi teknologjinë me valë BLUETOOTH, shikoni „Teknologjia BLUETOOTH me valë".

Rreth treguesit BLUETOOTH

Treguesi BLUETOOTH 8 lejon kontrollin e statusit të BLUETOOTH.

Statusi i sistemit	Statusi i treguesit
Sistemi është në gatishmërinë e BLUETOOTH (kur sistemi është i ndezur).	Pulson ngadalë në ngjyrë blu.
Gjatë çiftimit me BLUETOOTH	Pulson shpejt në ngjyrë blu.
Sistemi po përpiqet të lidhet me një pajisje BLUETOOTH.	Pulson

4 Kryeni veprimin e çiftimit në pajisjen BLUETOOTH dhe kërkoni për këtë sistem me pajisjen BLUETOOTH.

Kur kërkimi të ketë përfunduar, një listë e pajisjeve të gjetura mund të shfaqet në ekranin e pajisjes BLUETOOTH.

- Ky sistem shfaqet si „SONY:CMT-BT60" ose „SONY:CMT-BT60B". Nëse nuk shfaqet, kryeni përsëri procedurën nga hapi 1.
- Kur krijoni lidhjen me këtë sistem, zgjidhni profilin audio (A2DP, AVRCP) në pajisjen BLUETOOTH.
- Nëse pajisja BLUETOOTH nuk e mbështet AVRCP (Profili i kontrollit në largësi të audios e videos), nuk mund të kryeni riprodhimin ose veprime të tjera me këtë sistem.
- Për detaje mbi përdorimet e pajisjes BLUETOOTH që do të lidhni, referojuni manualit të përdorimit që shoqëron pajisjen tuaj BLUETOOTH.

5 Zgjidhni „SONY:CMT-BT60" ose „SONY:CMT-BT60B" në ekranin e pajisjes BLUETOOTH.

Nëse kërkohet që të futni një kod kalimi në pajisjen BLUETOOTH, futni „0000".

6 Përdorni pajisjen BLUETOOTH dhe realizoni lidhjen BLUETOOTH.

Kur çiftimi të ketë përfunduar dhe lidhja me pajisjen BLUETOOTH të jetë realizuar si duhet, ekrani 13 ndryshon në „BT AUDIO" nga „PAIRING" dhe treguesi BLUETOOTH 8 pulson ngadalë në blu.

Nëse varësi të llojit të pajisjes BLUETOOTH, lidhja mund të niset automatikisht pas përfundimit të çiftimit.

Shënime

- "Passkey" mund të quhet „Passcode", „PIN code", „PIN number" ose „Password", etj., në varësi të pajisjes.
- Statusi në gatishmëri i çiftimit në sistem anulohet pas rreth 5 minutash. Nëse çiftimi nuk kryhet me sukses, kryeni procedurën nga hapi 1.
- Nëse dëshironi që të çiftoni me disa pajisje BLUETOOTH, kryeni procedurën nga hapi 1 deri në 6 në mënyrë individuale për çdo pajisje BLUETOOTH.

Këshillë

Mundë të kryeni një veprim çiftimi ose të përpiqeni të bëni një lidhje BLUETOOTH me një pajisje tjetër BLUETOOTH ndërkohë që po krijohet lidhja BLUETOOTH me një pajisje BLUETOOTH. Lidhja BLUETOOTH aktualisht e vendosur do të anulohet kur të krijohet me sukses lidhja BLUETOOTH me një pajisje tjetër.

Për të spastruar informacionin e regjistrimit të çiftimit

1 Shtypni BLUETOOTH FUNCTION 3 në telekomandë ose shtypni FUNCTION 3 në mënyrë të përsëritur në njësi deri sa „BT AUDIO" të shfaqet në ekran 13.

Kur sistemi është i lidhur me një pajisje BLUETOOTH, emri i pajisjes i caktuar për pajisjen e lidhur BLUETOOTH shfaqet në ekranin 13 të sistemit. Shtypni BLUETOOTH 9 në njësi për të anuluar lidhjen me atë pajisje BLUETOOTH dhe më pas shfaqet „BT AUDIO".

2 Shtypni OPTIONS 33 për të shfaqur menynë e cilësimeve.

3 Shtypni ♦/♦ 23 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur „DEL LINK", më pas shtypni ⊕ 32.

4 Shtypni ♦/♦ 23 në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur „OK" dhe më pas shtypni ⊕ 32.

"COMPLETE" do të shfaqet dhe të gjitha informacionet e çiftimit do të spastrohen.

Shënim

